Në përgjigje të kërkesave tuaja të datës 13.10.2026, protokolluar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) me nr. 5453, datë 13.10.2026 dhe nr. 5453/1, datë 14.10.2026, nëpërmjet të cilave kërkoni të pajiseni me vërtetim të kategorisë dhe klasës së pagës së pozicionit "Auditues i lartë" pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfshirë çdo ndryshim të mundshëm të pagës së këtij pozicioni në periudhën 2024-2025, shprehemi si vijon:

Kompetenca e Departamentit të Administratës Publike në fushën e pagave parashikohet:

a) si pjesë e fushës së përgjegjësisë së DAP, në shkronjën "h", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, ku përcaktohet se DAP, në përputhje me legjislacionin në fuqi, harton dhe bashkëpunon për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore.
b) si pjesë e detyrave konkrete, në kuadër të kompetencave të Këshillit të Ministrave për caktimin e pagave, të trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve, në pikat 2, 3 dhe 4, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, konkretisht në shkronjën "a", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave, me propozimin e zëvendëskryeministrit ose të ministrit nën përgjegjësinë e të cilit është Departamenti i Administratës Publike, në rastin kur DAP-i është nën përgjegjësinë e një ministri, miraton:
"elementet përbërëse të pagës bruto mujore dhe vlerën për çdo element të pagës bruto mujore për të punësuarit në institucionet e administratës publike, për të cilët këto elemente nuk janë shprehur në ligjet e posaçme/të tjera, *me përjashtim të të punësuarve për të cilët kjo kompetencë i është dhënë një institucioni/organi tjetër sipas përcaktimit në këtë ligj*."

Projektvendimet e mësipërme të Këshillit të Ministrave vlerësohen dhe përgatiten nga Departamenti i Administratës Publike, që i bashkërendon ato me ministrin përgjegjës për financat për sa u përket efekteve të tyre financiare.

Pra, në rastet kur me ligj të posaçëm, kompetenca për përcaktimin e strukturës së pagës për të punësuarit i është dhënë një institucioni/organi tjetër, DAP-i nuk ka kompetencë të përgatisë aktet nënligjore përkatëse.

Duke iu referuar përcaktimit të sipërcituar të ligjit nr. 35/2023, të ndryshuar, sjellim në vëmendjen tuaj se, *një nga rastet përjashtimore* është miratimi i strukturës së pagës për të punësuarit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, institucion që organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 154/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Më konkretisht, referuar nenit 25, të ligjit nr. 154/2014, kompetenca e miratimit të strukturës së pagave dhe shpërblimeve i është dhënë titullarit të këtij institucioni. Sipas përcaktimeve ligjore, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është përgjegjës dhe vendos, ndër të tjera, për:

(i) strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
(ii) *strukturën e pagave dhe shpërblimeve të personelit*, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga sa më sipër, rezulton se klasifikimi i pozicioneve të punës dhe pagat e personelit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk miratohen nga Këshilli i Ministrave. Në këto kushte, Departamenti i Administratës Publike nuk disponon informacion për kategorinë dhe klasën e pagës për pozicionin ku ju keni ushtruar detyrën, e për rrjedhojë, nuk mund të lëshojë vërtetimin që kërkoni.

Për të siguruar vërtetimin për kategorinë dhe klasën e pagës, përfshirë dhe ndryshimet e mundshme në vite, lutemi t'i drejtoheni Kontrollit të Lartë të Shtetit, institucion ku keni ushtruar detyrën si "Auditues i Lartë".

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 31, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim, ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar,